



**Republika e Kosovës**



**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Në bazë të nenit 12.2 “d” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr 03/L-040, nenit 41.2 “ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, dhe propozimit nga Komisioni për riorganizimin e Administratës së Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 29.12.2011, mori këtë:

#### V E N D I M

##### Neni 1

Aprovohet Organogrami i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2012, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

##### Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës.

##### Neni 3

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i mëparshëm.

##### Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



**Republika e Kosovës**



**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12.2 pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 41.2 pika “d” të Statutit të komunës, Kuvendi i Komunës në Vushtrri, në mbledhjen e vet të mbajtur më 29.12.2011 mori këtë:

## V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale

### Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet neni 35.1 i Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale 01Nr.742/08, dhe do ta ketë këtë përmbajtje: “Subjektet afariste me rastin e aplikimit për leje pune lirohen nga pagesa e taksës”.

### Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural, dhe Drejtoria për Inspektime.

### Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi